



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 92, dt. 01.06.2015

Në mbështetje të nenit 32 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 01.06.2015, pasi shqyrtoi propozimet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit për shpallje monument kulture kategoria e I-rë dhe zonë të mbrojtur për objektin “Kisha e Shën Marisë”, Sinjë, Berat.
2. Miratimin e propozimit për shpallje monument kulture kategoria e I-rë dhe zonë të mbrojtur për objektin Ura e Kasabashit, Çorovodë.
3. Miratimin e propozimit për shpallje zonë e mbrojtur për objektin monument kulture, kat. II, “Burgu i Spaçit”, Spaç, Reps, Mirditë.
4. Miratimin e propozimit për shpallje zonë e mbrojtur për monumentin “Fortifikimi Antik i Kratullit”, Kodër-Boks, Postribë, Shkodër.
5. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI